

# Marrëveshja e Paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: **Mundësitë dhe Sfidat**

---



**Ky projekt është i mbështetur nga: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)**

**Autor: Bardhok Bashota**

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Instituti Demokratik i Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer i kanë të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

*Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe Fondacionit Konrad Adenauer.*

# Përmbajtja

---

Abstrakt	5
----------	---

---

Hyrje	6
-------	---

---

<b>1</b>	
<b>Konsiderata teorike për natyrën, përmbajtjen dhe implementimin e marrëveshjeve të paqes: këndvështrim sipas së drejtës ndërkombëtare</b>	<b>9</b>

---

Natyra e marrëveshjeve paqësore dhe statusi i tyre legal .....	10
Elementet përbërëse të një marrëveshje të paqes: praktika dhe raste .....	11
Faktorët dhe mekanizmat garantues për implementim të suksesshëm të një marrëveshje paqësore ....	12
Ratifikimi dhe regjistrimi i marrëveshjeve të paqes në Organizatën e Kombeve të Bashkuara .....	13

<b>2</b>	
<b>Në kërkim të marrëveshjes së paqes Kosovë - Serbi</b>	<b>15</b>

---

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në frymën e dialogut të Brukselit: rruga drejt marrëveshjes finale .....	16
Lojë fjalësh: marrëveshje të paqes apo marrëveshje për normalizim marrëdhëniesh? .....	18
Parimet dhe elementet përbërëse kyçe të marrëveshjes eventuale Kosovë-Serbi .....	19
Modaliteti dhe mekanizmat e garantimit dhe të implementimit të marrëveshjes .....	21

<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	<b>23</b>
------------------------------------	-----------

---

<b>Literatura</b>	<b>24</b>
-------------------	-----------

---

## Abstrakt

---

Që nga viti 2011, kur edhe filloi dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, kanë qarkulluar ide dhe janë zhvilluar një sërë debatesh për mundësinë e arritjes së një marrëveshje të paqes në formë të një dokumenti ligjërish të obligueshëm. Një qëndrim i tillë ka ardhur duke zënë vend gjithnjë e më tepër në kuadër të debateve mediatike, prononcimeve zyrtare të liderëve shtetëror nga Kosova dhe Serbia, dhe kohëve të fundit, edhe nga vet Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky studim hedhë dritë pikërisht mbi debatet aktuale për mundësinë e finalizimit të këtij dialogu përmes një marrëveshje të paqes të pranuar nga të dyja vendet, e cila do të kishte karakter obligativ, dhe që do të implementohej nën garancinë e bashkësisë ndërkombëtare dhe do të shërbente si platformë për një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë për të gjitha mosmarrëveshjet në mes të dy vendeve.

**Fjalë kyçe:** Marrëveshje paqësore, traktat, Kosovë, Serbi, BE, ShBA, normalizim marrëdhëniesh, paqe, stabilitet.

## Hyrje

Lidhur me mundësinë dhe nevojën e finalizimit të dialogut të Brukselit me një marrëveshje të paqes, duke aluduar madje edhe në një traktat të paqes në mes të dyja vendeve, kërkesat më të zëshme kanë ardhur si nga lidhshipi i lartë shtetëror i Kosovës, ashtu edhe nga diskursi publik në Kosovë.<sup>1</sup>

Një kërkesë kaq insistuese për palën kosovare është e bazuar në katër rrethana objektive. Fillimisht, një insistim i tillë bazohet në përvojat paraprake të dala nga dy përpjekje të mëhershme të bashkësisë ndërkombëtare për të arritur marrëveshje të paqes në mes Kosovës dhe Serbisë. Meqenëse nga pala serbe u refuzua edhe marrëveshja paqësore e dalë nga procesi i negociatave të Rambujesë 1999, edhe “Propozimi Gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisaari për Statusin Final të Kosovës”, që doli nga procesi negociator i Vjenës 2006 - 2007, asnjëherë nuk u arrit një marrëveshje e pranuar nga të dyja palët, përmes së cilës do të zgjidheshin përfundimisht të gjitha mosmarrëveshjet e tejzgjatura që të dyja vendet kanë në mes vete. Kjo qasje refuzuese e Serbisë tanimë është e ngulitur në kujtesën kolektive të lidhshpit politik dhe qytetarëve të Kosovës dhe ka bërë që ata t'i besojnë vetëm atij lloj modaliteti të rregullimit të mosmarrëveshjeve me Serbinë, i cili do të konkretizohet përmes një marrëveshje në formë të dokumentit ligjërish obligativ dhe nën garancinë ndërkombëtare, e veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimit Evropian (BE).

Së dyti, nuk është e rastësishme, madje është tejet e logjikshme, që nga pala kosovare të kërkohet e madje edhe të pritët arritja e një marrëveshje të tillë, kur kemi në konsideratë se vetë dialogu me Serbinë ka qenë me natyrë inkrementale (graduale), duke rrëshqitur prej dialogut teknik, drejtë atij politik, e që do të duhej përmbyllur me një marrëveshje paqësore

të karakterit obligativ. Së treti, përkundër faktit se implementimi i tërësishëm i të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialogun e Brukselit ende mbetet sfida në vete<sup>2</sup>, pala kosovare është mëse e bindur se implementimi i një marrëveshje finale me Serbinë nuk mund asesi të lihet e bazuar në konsiderata morale dhe të vullnetit politik të palës serbe, por që duhet të ketë karakter obligativ dhe nën garancinë ndërkombëtare. Së katërti, gjatë dy viteve të fundit, finalizimi i këtij procesi përmes një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative është kërkuar në mënyrë eksplicite nga vetë BE në njërën anë, dhe nga ana tjetër, nga ShBA-të. Ky qëndrim, e bënë insistimin e palës kosovare gjithnjë e më legjitim.

Në anën tjetër, pala serbe ka qenë më e përmbajtur në këtë drejtim, ani pse nuk kanë munguar zotimet as nga ana e tyre për ta finalizuar këtë dialog përmes një procesi paqësor me logjikë kompromisi, por pa aluduar në lidhjen e ndonjë marrëveshje të paqes në formë traktati apo të ngjashme. Përkundër që kanë kaluar njëzet vite që kur Serbia humbi praktikisht sovranitetin mbi Kosovën, në diskursin publik brenda Serbisë, qytetarët atje vazhdojnë ende të ofrojnë përshkrime emocionale për Kosovën. Studimet tregojnë se vetëm një numër i vogël i qytetarëve (më pak se 20 %), përkrahin një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme, e cila do të sillte edhe njohjen zyrtare të Kosovës nga Serbia. Pjesa më e madhe (mbi 70%), vazhdojnë të jenë kundër një skenari të tillë.<sup>3</sup> Në anën tjetër, lidhshipi shtetëror serb, insiston për një zgjidhje kompromisi, duke e lënë

1 Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA), “Zëri i Popullit rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë” (Vëllimi II), Qershor 2016, f.28.

2 Komisioni Evropian (2018) ‘Raporti për Kosovën’. SWD(2018) 156 final. Strasburg, 17.4.2018, f.49; Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA), “Studim mbi substancën dhe gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut Kosovë-Serbi”, Tetor 2019, f.20.

3 Center for Social Dialogue and Regional Initiatives (CSDRI), ‘Normalization of relations between Belgrade and Pristina from citizens perspective - What we know and what we feel?’, Belgrade, October 2019, f. 3-4.



Studimet tregojnë se vetëm një numër i vogël i qytetarëve **(më pak se 20%)**, përkrahin një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme, e cila do të sillte edhe njohjen zyrtare të Kosovës nga Serbia. Pjesa më e madhe **(mbi 70%)**, vazhdojnë të jenë kundër një skenari të tillë.

këtë option si shumë të paqartë<sup>4</sup>, përderisa ende në kushtetutën e Serbisë, Kosova konsiderohet si pjesë e saj.

Lidhur me pozicionin e komunitetit ndërkombëtar, BE, ShBA, Gjermani, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia, disa herë kanë shprehur qëndrimin e përbashkët se ato vazhdojnë t'i inkurajojnë Kosovën dhe Serbinë për t'u rikthyer në dialog dhe për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për të ardhmen e tyre euro-atlantike.<sup>5</sup>

Me qëllim të ofrimit të një koherence në analizimim e këtyre zhvillimeve, ky studim ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë fokusohet në trajtimin teorik për marrëveshjet paqësore që bëhen në kuadër të së drejtës ndërkombëtare të traktateve. Këtu, në radhë të parë, do të ofrohen shqyrtime konceptuale mbi natyrën dhe statusin legal të marrëveshjeve paqësore, llojin e tyre, elementet përbërëse, si dhe mekanizmat garantues gjatë procesit të implementimit të tyre. Një elaborim i tillë në frymën e së drejtës ndërkombëtare, krijon mundësi për një të kuptuar sistematik dhe koherent edhe mbi procesin e negociatave paqësore të Brukselit për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sidomos në sensin

që ai mund të prodhojë një marrëveshje gjithëpërfshirëse për zgjidhje të qëndrueshme për të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet tyre. Në pjesën e dytë, janë analizuar dinamikat e gjerëtanishme të dialogut të Brukselit, gjendja aktuale e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe zhvillimet dhe qëndrimet e fundit që mbajnë akterët e ndryshëm të përfshirë në këtë dialog lidhur me mundësinë e arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme ndërmjet të dyja vendeve. Kjo pjesë, po ashtu, do të elaborojë edhe opsionet dhe mundësitë për arritjen e një marrëveshje të tillë në mes dy vendeve, duke përfshirë këtu edhe elementet që do të duhej t'i përmbante ajo, e të cilat, do ta përbënin esencën e zgjidhjes së çështjeve të hapura dhe që do të shtronin një rrugë për bashkëpunim konstruktiv dhe afatgjatë për të dyja vendet.

4 Gazeta Metro: "Francezët e zënë ngushtë Vucicin: Nëse jo shkëmbimi, çfarë është për ty kompromisi?", (23/11/2019 | 15:32), e qasshme në: <https://gazetametro.net/francezet-e-zene-ngushte-vucicin-nese-jo-shkembimi-efare-eshte-per-ty-kompromisi/>; Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) & Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG), Skenarët e 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Prill, 2018, f. 16.

5 U.S. Embassy in Serbia: Joint Statement by the Governments of France, Germany, Italy, the United Kingdom and the United States, e qasshme në: [https://xk.usembassy.gov/joint\\_statement\\_by\\_ambassadors/](https://xk.usembassy.gov/joint_statement_by_ambassadors/)

# 1

**Konsiderata teorike për  
natyrën, përmbajtjen  
dhe implementimin e  
marrëveshjeve të paqes:  
këndvështrim sipas së  
drejtës ndërkombëtare**

---

# Konsiderata teorike për natyrën, përmbajtjen dhe implementimin e marrëveshjeve të paqes: këndvështrim sipas së drejtës ndërkombëtare

## Natyra e marrëveshjeve paqësore dhe statusi i tyre legal

Në kuadër të studimeve më të reja për proceset paqësore dhe marrëveshjet që dalin nga ato, studiuesit konstatojnë se sa më shumë që evoluojnë dhe profilizohen nën-fushat për këto lloj studimesh, aq më shumë rritet llojlloshmëria e dokumenteve që krijohen si marrëveshje të paqes.<sup>6</sup> Një domosdoshmëri gjithnjë në rritje për ta studiuar rolin e marrëveshjeve paqësore, si instrumente për përfundimin e konflikteve, erdhi në fund të viteve 90-ta. Kjo domosdoshmëri ka qenë e lidhur ngushtë me kontekstin e diversifikimit gjithnjë e më të madh të natyrës së konflikteve në skenën ndërkombëtare, për faktin se gjatë kësaj periudhe, konfliktet me natyrë brenda shtetërore kishin filluar të bëheshin mjaft të përhapura.<sup>7</sup> Kjo kishte imponuar nevojën e ndërmarrjes së shumë aktiviteteve për negociata paqësore, nga të cilat kishin rezultuar edhe marrëveshje konkrete të paqes, kryesisht në formë të traktateve të paqes.

Në kuadër të debateve ndërmjet autorëve të së drejtës ndërkombëtare të traktateve dhe të politologëve, edhe për faktin e “mbizotërimit të dokumenteve që mund të përshkruhen si marrëveshje paqeje...termi ‘marrëveshje paqeje’ mbetet kryesisht

i papërcaktuar dhe i pashpjeguar qartë”.<sup>8</sup> Me gjithë këtë, një qartësi më e madhe për marrëveshjet e paqes ofrohet përmes: a) definimit terminologjik të nocionit të tyre, b) kategorizimit të të gjitha llojeve të tyre në disa grupe kryesore, në bazë të kriterit të përmbajtjes së dispozitave të tyre, dhe c) sqarimit se si deri në çfarë niveli ato marrin formë të njohura juridike, gjegjësisht ‘legalizohen’.

Në një vështrim më të përgjithshëm, konsiderohet se marrëveshjet e paqes ofrojnë një lloj qasje të bazuara në rregulla dhe manifestohen si vendosje e një paqeje me anë të një dokumenti shumë formal.<sup>9</sup> Pra, për dallim nga paktet politike që mund të lidhin akterët ndërkombëtar ose thjeshtë dokumentet me natyrë deklaruese, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë instrumente ligjërish të detyrueshme dhe që kanë mekanizma konkret të implementimit të tyre.<sup>10</sup> Siç mund të shihet, termi marrëveshje ndërkombëtare dhe traktat ndërkombëtar, përdoren ndërkëmbyeshëm, duke aluduar pak a shumë në të njëjtin lloj të dokumentit. Madje, sipas nenit 2 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, theksohet qartë se një traktat është «një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur midis shteteve në formë të shkruar dhe e rregulluar nga e drejta ndërkombëtare, qoftë e mishëruar në një, dy, apo më shumë të lidhura dhe cilido qoftë përcaktimi i tij i veçantë». <sup>11</sup> Pra, nëse bazo-

6 Ghassem Bohloulzadeh, “The Nature of Peace Agreement in International Law”, *Journal of Politics and Law*; Vol. 10, No. 2; 2017, p.208; Christine Bell: *Peace Agreements: Their Nature and Legal Status*, *The American Journal of International Law* · May 2008, f. 373-385.

7 Paul R. Hensel (2001): *The More Things Change: Recognizing and Responding to Trends in Armed Conflict*: Florida State University, 2001, f.4.

8 Bell: *Peace Agreements*, 2008, f.374.

9 Bohloulzadeh, 2007, f.208.

10 Antonio Cassese (2005): *International Territorial Law* 63.

11 Vienna Convention on the Law of Treaties, May 23, 1969, Art. 2, 1155 UNTS 331, e qasshme në: [https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1\\_1\\_1969.pdf](https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf)



hemi mbi mënyrën se si kjo konventë i përcakton marrëveshjet ndërkombëtare, del se disa marrëveshje të paqes duket se janë traktate. Madje, në traktat mund të aludohet edhe mbi disa lloje të marrëveshjeve paqësore përmes të cilave adresohen konflikte me natyrë brenda shtetërore. Studiuuesit i referohen shpesh rastit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kornizë për Paqen në Bosnje dhe Hercegovinë, që shkurt njihet edhe si Marrëveshja e Paqes së Dejtonit.

Lidhur me kategorizimin e marrëveshjeve të paqes, autorët marrin si kriter fazat e ndryshme të mosmarrëveshjeve si dhe materien që ato rregullojnë në një kontekst konfliktual. Kështu, një model kategorizimi mjaft i përhapur në literaturën e studiuesve të paqes përbëhet nga tri nivele sistematike të marrëveshjeve paqësore: marrëveshje paqeje përpara-negociatave, marrëveshje kornizë (marrëveshje përmbajtësore) dhe marrëveshje ekzekutive (marrëveshje të rinegociueshme).<sup>12</sup> Bazuar në shumicën e praktikave të përmbajtjes së marrëveshjeve të paqes, ato përfshijnë informacione për pesë karakteristikat kryesore. Ato përmbajnë dispozita për çështjet ushtarake, politike, territoriale, të drejtësisë dhe, së fundi, dispozita që lidhen me zbatimin e vetë marrëveshjeve.<sup>13</sup>

Edhe pse marrëveshjet e paqes janë dokumente të legalizuara qartë, prapë se prapë, është mjaftë vështirë për t'i vendosur ato brenda kategorive ekzistuese juridike të marrëveshjeve ndërkombëtare, kjo për faktin që ka një diversifikim të përmbajtjes dhe llojit të subjekteve që i nënshkruajnë ato.<sup>14</sup> Për ta kuptuar më mirë statusin juridik të marrëveshjeve paqësore, disa studiues kanë vendosur disa kritere përmbajtësore që tregojnë nivelin e 'legalitetit' të tyre, dhe atë: sa 'juridike' është natyra e dokumentit, saktësia me të cilën është hartuar, dhe sa ka përcaktuar autoritet

për një palë të tretë në lidhje me interpretimin dhe implementimin e saj.<sup>15</sup>

### Elementet përbërëse të një marrëveshje të paqes: praktika dhe raste

Në përgjithësi konsiderohen tri pjesë kryesore që përmbajnë traktatet: pjesën hyrëse, që trajton rrethanat që sjellin deri te hartimi i traktatit; pjesën përmbajtësore, që përmban tematikën e tij; dhe pjesën e dispozitave kalimtare, që definohet si pjesë teknike që fut traktatin në fuqi dhe efektet e tija kundrejt akteve të tjera për çështjen e njëjtë. Ndërkohë që, në kuptimin përmbajtësor traktatet nuk kanë ndonjë rregull uniforme për përmbajtjen, sepse për më shumë se kaq, secili traktat synon të rregullojë një materie të caktuar e cila është e ndryshme nga materie të tjera. Sidoqoftë, traktatet e paqes u referohen këtyre aspekteve:

→ **NDËRPRERJA E ARMIQËSIVE:** është pothuajse elementi i parë dhe i patejkalueshëm i traktatit të paqes për faktin që ky element krijon parakushtet tjera të ecjes përpara në zbatimin e mëtejshëm të Traktatit të Paqes. Kësisoj, Marrëveshja e Dejtonit<sup>16</sup> në nenin 2 të saj parasheh ndërprerjen e armiqësive dhe parandalimin e çfarëdo operacioni ofensiv kundrejt njëri tjetrit, përfshirë këtu edhe shkëmbimin e të burgosurve dhe robërve të luftës.

→ **TERRITORIALE/KUFIJTË:** nisur nga fakti se zhvillimi i armiqësive ka sjellë si pasojë edhe lëvizjen e kufijve shtetëror apo ndryshime të ndryshme territoriale, një traktat i paqes, domosdoshmërisht përfshinë këtë element dhe e trajton me seriozitet. Parimisht, tek çështja e territorit dhe kufijve shtetëror, kemi dy situata:

- Mospranimi i ndryshimeve territoriale në pajtim me Aktin Final të Helsinkit<sup>17</sup> (1975), për mos

12 Peter Wallensteen & Margareta Sollenberg, "Armed Conflicts, Conflict Termination and Peace Agreements, 1989-96", *Journal of Peace Research*, vol. 34, no.3, 1997, f.34.

13 Peace Agreements 1975-2011 - Updating the UCDP Peace Agreement Dataset STINA HÖGBLADH Uppsala Conflict Data Program (UCDP), Department of Peace and Conflict Research, Uppsala University, f. 44, i qasshëm në: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.739.1886&rep=rep1&type=pdf>

14 Bell, p.379.

15 Ibid, p.385.

16 The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina (1995), i qasshëm në: <https://www.osce.org/bih/126173?download=true>

17 Conference on Security and Co-Operation in Europe Final Act, HELSINKI (1975), i qasshëm në: <https://www.osce.org/helsinki-final-act?download=true>

ndryshimin e kufijve edhe përkundër faktit se Akti Final i Helsinkit nuk ka karakter obligativ dhe nuk ka status të traktatit. Gjithsesi, se si praktikë ka pasur dhe ka respekt dhe zbatueshmëri ndërkombëtare.

- Uti Possidetis – pranimi i ndryshimit të kufijve shtetëror që kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve gjatë luftës dhe bazohet në parimin “meqë e ke mbaje”. Sipas këtij parimi janë krijuar shtetet afrikane dhe po ashtu ato të Amerikës Latine. Në kontekst të Ballkanit Perëndimor, ky parim ka shërbyer në ndërprerjen e armiqësive në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe është bërë pjesë e Marrëveshjes së Dejtonit duke e formalizuar ndarjen e territorit të Bosnjë e Hercegovinës në linjat ndër-etnike<sup>18</sup> në *Federatën Boshnjako* - Kroate dhe Republikën Serbe të Bosnjës.

→ **POLITIKE:** aspektet politike përfshirë raportin e ndërsjellë të palëve (njohja) për periudhën e pasluftës. Po ashtu, në këtë kuadër trajtohen edhe mbetja në fuqi respektivisht tërheqja nga obligimet juridike ndërkombëtare (traktatet) me të cilat shteti paraprak ka pasur të lidhur (traktatet politike, ushtarake, pasuria dhe borxhi publik).

→ **REPARACIONET:** dëmet e shkaktuara gjatë periudhës së armiqësive që si parim i ngarkohen palës e cila e ka filluar luftën. Reparacionet e luftës, në mënyrë tipike, janë rregulluar me Traktatin e Versajës<sup>19</sup> përmes të cilit ngarkoheshin Gjermania dhe Italia që të paguanin dëmshpërblim për shtetet fituese të luftës.

### Faktorët dhe mekanizmat garantues për implementim të suksesshëm të një marrëveshje paqësore

Studiuesi Hampson, thekson se ekzistimi i marrëveshjeve të paqes, në kuptimin e një dokumenti formal, është diçka më pak se sa një tregues rruge

kah paqja e vërtetë.<sup>20</sup> Andaj, në jetësimin e një procesi paqësor që përfundon me një marrëveshje të paqes, rol vendimtarë ka implementimi sa më efektiv i saj, sidomos në terma të objektivave kryesore. Se çka e bënë një marrëveshje të obligueshme efektive në terma të implementimit, është çështje debatesh. Studiuesit përmendin disa faktorë që ndikojnë direkt dhe indirekt në implementim ose mos implementim të një marrëveshje. Për shembull, Hehn, përmend disa faktorë të rëndësishëm ndikues në implementim të marrëveshjeve. Para së gjithash, ai fokusohet te roli i ambientit, gjegjësisht rrethanave kontekstuale ku implementohet marrëveshja; gatishmëria e lidershit shtetëror për të treguar vullnet politik dhe për të aplikuar qasje konstruktive ndaj marrëveshjeve; po ashtu, rol kanë edhe tipologjia dhe shkalla e statusit legal dhe natyra e obligimeve të krijuara me marrëveshje; si dhe statusi dhe pozicioni që mbajnë palët e treta që mund të përfshihen në një proces garantimi për implementim të marrëveshjes.<sup>21</sup> Tjerë studiues, vëmendje iu kushtojnë edhe disa faktorëve tjerë si: saktësia e objektivave afatshkurtra që marrëveshja ka paraparë; saktësia terminologjike e dispozitave të marrëveshjes; ‘vlerat kushtetuese si legalizim alternativ’; përfshirja e shteteve apo organizatave ndërkombëtare si ‘dëshmitarë’, ‘garantues’ dhe ‘monitorues’ të implementimit të marrëveshjes.<sup>22</sup>

Ka studime që tregojnë se niveli i mos implementimit të marrëveshjeve të paqes në kohët moderne, ka qenë shumë i lartë. Sipas një studimi, tregohet se në periudhën ndërmjet viteve 1975-2011, më shumë se 35% e marrëveshjeve të paqes të arritura kurrë nuk janë implementuar.<sup>23</sup> Ky fakt, nxjerrë në pah dobësinë e normave dhe mekanizmave ndërkombëtar për të imponuar rregulla të sjelljes për shtetet dhe palët tjera kontraktuese dhe tregon se në pjesën më të madhe të rasteve, çështja e implementimit të marrëveshjeve paqësore mbetet krejtësisht në diskrecion të vullnetit politik të shteteve dhe në suaza

18 Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina, 1995, Anex II.

19 Neni 231 i Traktatit të Versajës.

20 Fen Osler Hampson (1996): *Nurturing peace: why peace settlements succeed or fail*, United States Institute of Peace Press, p.221.

21 Arist von Hehn (2011): *The internal Implementation of Peace Agreement after Violent Intrastate Conflict*, Martinus Nijhoff Publishers, Lieden, Boston, 2011. f.37-53.

22 Bell: *Peace Agreements*, 2008, f. 395-400.

23 *Peace Agreements 1975-2011*, f.53.

të mirëbesimit. Pavarësisht një rregulli të njohur në të drejtën ndërkombëtare siç është *pacta sunt servanda* (marrëveshjet duhet respektuar), Karta e OKB-së (neni 2, paragrafi 2) dhe Konventa e Vjenës e vitit 1969 (neni 26), kanë paraparë dispozita që theksojnë obligueshmërinë e palëve për t'i respektuar marrëveshjet, gjegjësisht tregimin e mirëbesimit në implementimin e tyre.

Vlenë të përmendet modeli i rregullimit të garantimit në implementim dhe interpretim të Marrëveshjes së Prespës së vitit 2018, e lidhur ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut.<sup>24</sup> Marrëveshja e Prespës paraqet marrëveshje ndërmjet shteteve sovraane, e cila është negociuar nën ndërmjetësimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Ajo ka karakter obligativ ndërkohë që masat që garantojnë zbatimin e saj janë: a) Ratifikimi i saj u bë së pari nga pala e dytë (Maqedonia Veriore) dhe me pas nga pala e parë (Greqia); b) Shërbimet e mira - sipas Nenit 19, pika 2, palët kanë të drejtë që në rast kontesti të drejtohen tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për të kërkuar shërbime të mira si mjete diplomatike të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, dhe c) Për çfarëdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshje, e që palët nuk arrijnë ta zgjidhin sipas nenit 19 (2) (pra, përmes shërbimeve të mira), palët kanë të drejtë që të dyja bashkë, ose individualisht, ta dërgojnë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

### Ratifikimi dhe regjistrimi i marrëveshjeve të paqes në Organizatën e Kombeve të Bashkuara

**Ratifikimi i marrëveshjeve të paqes** - nënkupton konfirmimin retroaktiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Neni 14 i Konventës së Vjenës<sup>25</sup> thekson se ratifikimi shpreh vullnetin e shteteve që do jenë të obliguar me traktatin në secilin rast kur e parasheh

traktati. Mbi këtë bazë, ekziston një kontradiktë lidhur me atë se kur marrëveshjet duhet të ratifikohen. Disa studiues mendojnë se ratifikimi është i nevojshëm vetëm nëse në mënyrë të qartë parashihet nga palët në traktat. Kjo qasje është e pranuar nga Britania e Madhe.<sup>26</sup> Në anën tjetër, po ashtu sugjerohet se ratifikimi është i nevojshëm në secilin rast pos rasteve kur marrëveshja parasheh ndryshe.<sup>27</sup> Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar llojin e marrëveshjeve që kërkojnë ratifikim. Neni 17 i kushtetutës thekson se; "Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; (2) të drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës."<sup>28</sup>

**Regjistrimi i marrëveshjes së paqes në Kombet e Bashkuara** - Çështja e regjistrimit të 'traktateve' dhe 'marrëveshjeve tjera ndërkombëtare' shprehimisht është rregulluar me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Sipas kësaj dispozite, çdo traktat apo marrëveshje ndërkombëtare duhet të deponohet dhe të regjistrohet në Sekretariat<sup>29</sup>

26 Malcolm Shaw (2003): *International Law - Fifth Edition*, Cambridge University Press, 2003, f. 820.

27 Ibid.

28 Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

29 Regjistrimi i Marrëveshjes së Paqes në kuptimin procedural do nënkuptonte: a) përgatitjen e gjithë materialit (përfshirë tekstin në gjuhët autentike, rezerva, deklarata, anekse etj); b) masat kontrolluese nëse eventualisht marrëveshja e paqes është e regjistruar më herët; c) verifikimin nëse eventualisht ka referenca në marrëveshje të tjera; d) përgatitjen kopje e certifikuar e gjithë tekstit të Marrëveshjes; e) nëse marrëveshja është hartuar në më shumë se një gjuhë atëherë përgatitet kopja e certifikuar e Marrëveshjes në të gjitha gjuhët; f) kur Marrëveshja nuk hartohet në gjuhë Angleze ose Frënge, përgatitet nga një kopje e fortë në Anglisht dhe Frëngjisht; g) përgatitjen gjithë materialin në formë elektronike dhe ngarkimi në CD, DVD dhe po ashtu dërgohen në email; [treatyregistration@un.org](mailto:treatyregistration@un.org); h) dërgimin me postë ose in personam në: Treaty Section, Office of Legal Affairs, 380 Madison Avenue, 13 floor, New York, N.Y. 10017, United States of America; i) data e dorëzimit në Sekretariat i llogaritet si date e regjistrimit dhe po ashtu dorëzuesi do e marrë certifikatën e dorëzimit; j) Nëse ka nevojë për dokumente shtesë, kjo do i kërkohej dorëzuesit. Shih më tej në: United Nations, 'Treaty Collection', e qasshme në: [https://treaties.un.org/Pages/Content.aspx?path=DB/UNTS/pagelIntro\\_en.xml](https://treaties.un.org/Pages/Content.aspx?path=DB/UNTS/pagelIntro_en.xml)

24 Final Agreement for the Settlement of the Differences as Described in the United Nations Security Council Resolutions 817 (1993) And 845 (1993), The Termination of the Interim Accord of 1995, and the Establishment of a Strategic Partnership Between the Parties, (2018), e qasshme në: <https://vlada.mk/sites/default/files/dokument/spogodba-en.pdf>

25 Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve.



Në kuadër të debateve ndërmjet autorëve të së drejtës ndërkombëtare të traktateve dhe të politologëve, edhe për faktin e “mbizotërimit të dokumenteve që mund të përshkruhen si marrëveshje paqeje...termi ‘marrëveshje paqeje’ mbetet kryesisht i papërcaktuar dhe i pashpjeguar qartë

e OKB-së sa më shpejtë që është e mundur.<sup>30</sup> Për ta fuqizuar këtë nen, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përmes Rezolutës 97(1) të 14 dhjetorit të vitit 1946, miratoi edhe rregulloret, të cilat ofrojnë më shumë detaje, për regjistrimin e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>31</sup> Neni 2 i rregullorës parasheh që një marrëveshje nuk mund të regjistrohet para se ajo së pari të ketë hyrë në fuqi ndërmjet palëve nënshkruese; kurse, në nenin 10, parashihet edhe deponimi dhe regjistrimi i disa kategorive të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që nuk i nështroheshin statusit të marrëveshjeve sipas nenit 102, e që kishin të bënin vetëm me marrëveshjet dhe traktatet e lidhura ndërmjet shteteve anëtare të OKB-së. Pra, neni 10, pika c), e njeh mundësinë dhe i detyron edhe shtetet që ende nuk janë anëtare të OKB-së që të dergojnë për regjistrim ndonjë marrëveshje ku ato janë palë kontraktuese.<sup>32</sup>

Nisur nga interpretimi i këtyre dispozitave, edhe në rastin e arritjes së një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, secili nga të dyja vendet do të kishin mundësinë ta depononin marrëveshjen për regjistrim në sekretariat, madje edhe pse Kosova nuk do ta kishte ende statusin e vendit anëtar të OKB-së. Megjithë këtë, meqenëse nuk ka ndonjë afat kohor preciz për regjistrimin e traktateve dhe të marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare, atëherë egzistojnë mundësi reale që, pas një marrëveshje finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, njëra nga këto vende të dërgonte marrëveshjen në fjalë për regjistrim dhe atë në cilësi të shteteve sovraane. Ky skenarë do të mund të aplikohet vetëm nëse marrëveshja finale do të parashihet njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe që Kosovës do t'i garantonte ulëse në OKB. Në këto rrethana, pasi që Kosova ta fuqizonte këtë marrëveshje përmes ratifikimit, do të krijoheshin të gjitha mundësitë dhe do të plotësohej edhe kriteri formal për ta deponuar atë në Sekretariatin e OKB-së për regjistrim dhe publikim.

30 Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 102.

31 General Assembly, Resolution adopted by the General Assembly on 20 December 2018 (A/RES/73/210), 14 January 2019, e qasshme në: <https://treaties.un.org/doc/source/docs/A-RES-73-210-Eng.pdf>

32 Zejnullah Gruda (2003): *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Universiteti i Prishtinës, 2003, f.277.

# 2

**Në kërkim të  
marrëveshjes së paqes  
Kosovë-Serbi**

---

# Në kërkim të marrëveshjes së paqes Kosovë-Serbi

## Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në frymën e dialogut të Brukselit: rruga drejt marrëveshjes finale

Historia më e re e armiqësisë së hapur në mes Kosovës dhe Serbisë filloi në vitin 1989, kur aso kohe, në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, u bë suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës. Tani kur saktësisht po përmbushën tri dekada që nga ajo kohë, ende nuk duket të ketë një perspektivë shumë të qartë se kur mund të përfundojë konteksti konfliktual i marrëdhënieve në mes të dyja vendeve. Në fakt, marrëdhëniet konfliktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përgjatë këtyre tri dekadave, e kanë dominuar pothuajse të gjithë diskursin e zhvillimeve politike në hapësirën e Ballkanit Perëndimor. Përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të paqësuar kontekstin e marrëdhënieve ndërmjet tyre kanë qenë përherë evidente dhe janë manifestuar në kuadër të disa aktiviteteve diplomatike, përmes të cilave janë udhëhequr procese tejet komplekse të negociatave paqësore.

Gjatë këtyre proceseve, tejet i veçantë ka qenë roli i ShBA-ve dhe së fundmi edhe i BE-së, ku këta dy aktorë kanë kornizuar dhe ndërmjetësuar proceset negociatore në mes të dyja vendeve në përpjekje për të prodhuar një zgjidhje paqësore për të gjitha mosmarrëveshjet e tejzgjatura dhe politikisht mjaft të ndjeshme. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga institucionet e saj legjitime me 2008, u krijua një momentum i ri politik ndaj të cilit u reagu në mënyra të ndryshme. Sado që pjesa dërmuese e shteteve anëtare të BE-së (përfshirë edhe disa nga shtetet më të fuqishme të botës demokratike), e njohën pavarësinë e Kosovës; Serbia refuzoi kategorikisht ta bënte një gjë të tillë, madje filloi një projekt minimi të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Fillimisht, Serbia i'u drejtua me një pyetje Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) për të marrë

një opinion këshillëdhënës nëse ky akt i shpalljes së pavarësisë nga institucionet e Kosovës ishte në akordancë me të drejtën ndërkombëtare. Pas më shumë se dy vite të përpjekjeve aktive të Serbisë për ta penguar Kosovën në forcimin e subjektivitetit të saj në arenën ndërkombëtare, me 22 Korrik 2010, GjND vendosi se “deklarata nuk ka shkelur ndonjë rregull të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare”.<sup>33</sup> Megjithatë, në të njejtën ditë me shpalljen e verdiktit të GjND-së, (EEAS), bëri një deklaratë të përbashkët ku theksohej se tanimë verdikti kishte hapur një fazë të re në të cilën BE shprehej e gatshme të lehtësonte një dialog për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, dhe se të dyja vendet e kishin të ardhmën në BE.<sup>34</sup> Pas këtyre zhvillimeve, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e adoptoi një rezolutë konsensuale në tetor të vitit 2010, ku mirëpriti gatishmërinë e BE-së për të lehtësuar dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë ku theksohej se “dialogu do të ishte promovimi i bashkëpunimit, arritje e përparimit në rrugën drejt BE-së dhe përmirësimi i jetës së njerëzve”.<sup>35</sup> Mbi këtë bazë, BE u përfshi në këtë proces përmes një qasje proaktive, gjë që ende vazhdon të mbetet angazhimi më ambicioz i ndërmarrë ndonjëherë nga kjo e fundit në kuadër të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (ang. EEAS).

Që nga viti 2011, nën udhëheqjen e zyrtarëve më të lartë të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, u organizuan 40 raunde negociatash të nivelit të

33 International Court of Justice (2010): Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo. Request for Advisory Opinion (22 July 2010), icj Reports, 403.

34 European External Action Service, 2010, e qasshme në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_PESC-10-213\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_PESC-10-213_en.htm)

35 UN General Assembly Resolution (2010): Request for an Advisory Opinion of the International Court of Justice on Whether the Unilateral Declaration of Independence of Kosovo Is in Accordance With International Law (13 October 2010) A/RES/64/298, e qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezoluta\\_e\\_OKB\\_per\\_Dialogun\\_e\\_Brukselit\\_e\\_9\\_Shtator\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezoluta_e_OKB_per_Dialogun_e_Brukselit_e_9_Shtator_2010.pdf)



lartë, pa përmendur fare raunde të panumërta negociimesh teknike. Të gjitha këto raunde u zhvilluan në tri faza, nga ku palët arritën marrëveshje në 33 çështje, si të karakterit teknik, ashtu edhe politik.<sup>36</sup> Më e rëndësishmja nga këto marrëveshje mbeti 'Marrëveshja e Parë që Udhëheqë Parimet e Normalizimit të Marrëdhënieve', e njohur shkurt si Marrëveshja e Brukselit, e arritur me 19 Prill 2013. Kjo marrëveshje e përbërë nga 15 pika, ofroi parametrat bazik për integrimin e veriut të Kosovës<sup>37</sup> në kuadër të rendit Kushtetues të Kosovës dhe vendosi linjat për normalizim të marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Por, aktualisht cila është gjendja reale e normalizimit?

Periodha në mes viteve 2017-2019 ka qenë plotë tensione dhe incidente në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, BE nuk e ka zbehur përkushtimin e saj për t'i nxitur të dyja palët që t'i ktheheshin vazhdim të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre.<sup>38</sup> Brenda këtyre dy viteve ka pasur disa takime në mes Presidentit Serb Aleksandar Vučić dhe Presidentit Kosovar Hashim Thaçi, të ndërmjetësuar nga Përfaqësuesja e Lartë Mogherini. Të dyja palët janë dakorduar për një fazë të re dhe finale të dialogut që do të shpinte drejt arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizim të plotë të marrëdhënieve.

Për BE-në, gjendja faktike e implementimit të marrëveshjeve të arritura paraprakisht nuk është e mjaftueshme.<sup>39</sup> Kjo situatë, si duket ka ndikuar që zyrtarët e EEAS që ta përqendrojnë përkushtimin

në nxitjen e palëve drejt arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse që do të zgjidhte të gjitha çështjet e hapura në mes tyre. Në strategjinë për zgjerim të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, e publikuar nga Komisioni Evropian në shkurt të 2018, për herë të parë BE në mënyrë decizive theksohet se kusht esencial për të përparuar në rrugën e tyre evropiane, të dyja vendet duhet të arrijnë 'Një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizim, ligjërisht të obligueshme' (ang. a comprehensive, legally-binding normalisation agreement).

Përveç kësaj, një nga karakteristikat e zhvillimeve të fundit rreth procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve, është përfshirja direkte e ShBA-ve në këtë proces, ndonëse e deklaruar me një rol mbështetës për të dyja palët negociatore si dhe për BE-në si lehtësues i procesit. Duke qenë dëshmitarë të stagnimit total të procesit negociator, edhe ShBA-të edhe BE kanë aplikuar një qasje stimuluese për palët, duke i inkurajuar ato të lëvizin përpara drejt arritjes së një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjeve. Në këtë drejtim janë vlerësuar si mjaftë inkurajuese letrat që Presidenti i ShBA-ve, Donald Trump ua ka dërguar të dy presidentëve Thaçi dhe Vučić në fund të vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019. Presidenti amerikan u ka bërë thirrje të dyja palëve për konsensus të brendshëm dhe për ndërmarrjen e përpjekjeve që do ta lehtësonin procesin e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse, e cila do t'i kontribuonte paqes, stabilitetit dhe prosperitetit për të dyja vendet dhe për mbarë rajonin e Ballkanit. President Trump ka qenë mjaft deciziv, duke ua bërë me dije të dyja palëve se: "...Dështimi për të përfituar nga kjo mundësi unike do të ishte një pengesë fatale, pasi një mundësi tjetër për një paqe gjithëpërfshirëse nuk ka gjasa të ndodhë përsëri së shpejti".<sup>40</sup> Në letrën e dytë, Trump ka shtuar se... "Ne e shohim njohjen e ndërsjellë si themelin e marrëdhënieve të normalizuara dhe bazën për çdo zgjidhje gjithëpërfshirëse"<sup>41</sup> Iniciativë konkrete lidhur

36 RIDEA & BPRG, Prill, 2018, f.4.

37 Kjo pjesë përbëhet nga katër komuna: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani, të cilat janë të banuara etnikisht me shumicë serbe.

38 Miruna Troncota: "Brussels Based Talks are a Dialogue of the Deaf", Kosovo 2.0 (23.02.2017), e qasshme në: <https://kosovotwopointzero.com/en/brussels-based-talks-dialogue-deaf/>

39 Komisioni Evropian (2018) 'Raporti për Kosovën'. SWD(2018) 156 final. Strasburg, 17.4.2018, f.49, qasshëm në [https://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo\\_report\\_2018\\_shqip.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo_report_2018_shqip.pdf) Një vlerësim real i shkallës së implementimit të të gjitha marrëveshjeve Kosovë-Serbi mbetet mjaft sfidues, "sepse palët negociuese në vazhdimësi kanë shpalosur interpretime të ndryshme, tek sa edhe BE shpesh herë nuk ka intervenuar për të mbështetur apo hedhur poshtë pohimet e përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë". (Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) & Transparency International Kosova: Dialogu Kosovë – Serbi: sfidat dhe rruga përpara, Mars 2018, f. 18).

40 *President of Kosovo 2018*, i qasshëm në: <https://www.president-ksgov.net/en/news/president-thaci-received-a-letter-from-the-president-of-the-usa-donald-trump>

41 *President of Kosovo 2019*, i qasshëm në: <https://www.president-ksgov.net/en/news/president-trump-congratulates-president-thaci-on-the-11th-anniversary-of-the-independence-reiterates-the-importance-of-normalisation-of-relations-with-serbia>

me shtendosjen e raporteve Kosovë-Serbi erdhi edhe përmes kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez Emmanuel Macron në marginat e Samitit të Liderëve të Ballkanit Perëndimor që u mbajt në Berlin në prill të këtij viti.

Aktualisht, nuk ka ndonjë skenar të qartë se si do të ecet më tutje me procesin e dialogut. Përderisa qeveria e Serbisë e kushtëzon dialogun me heqjen e tarifës doganore 100% për produktet që importoheshin nga Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina; në anën tjetër qeveria e Kosovës deri tani e ka kushtëzuar heqjen e kësaj tarife me marrjen e njohjes formale të shtetësisë së saj nga Serbia.<sup>42</sup> Gjatë kësaj vjeshte, ShBA-të janë aktivizuar fuqishëm në nxitjen dhe mbështetjen e Kosovës dhe Serbisë për rikthim në dialog. Konkretisht një mbështetje tillë do të vije nga Zëvendës Ndihmësi i Sekretarit të Shtetit, Matthew Palmer dhe i dërguari i posaçëm i presidenti të ShBA-ve, Richard Grenell.

### Lojë fjalësh: marrëveshje të paqes apo marrëveshje për normalizim marrëdhëniesh?

Çështja e aplikueshmërisë së një terminologjie unike nga ana e BE-së, si lehtësues i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga dukuritë më të spikatura të këtij procesi. Terminologji unike u përdor për ta emërtuar vetë dialogun dhe pastaj edhe për marrëveshjet që rezultuan prej tij. Mund të konsiderohet se janë dy faktorë që e kanë shtyrë BE-në të operacionalizojë me terminologji të tilla në këtë proces. Së pari, meqenëse vetë BE për nga statusi juridik dhe politik është një entitet unik në arenën ndërkombëtare, po ashtu, edhe aplikimi i qasjeve të tij në procese dialoguese, kur ai paraqitet si lehtësues ose ndërmjetësues, janë po ashtu unike. Së dyti, në rastin e lehtësimit të këtij dialogu, aplikimi i një terminologjie të tillë unike u imponua nga rrethana kontekstuale. Konkretisht, meqenëse linja bazike që duhej ndjekur me kujdes gjatë gjithë këtij procesi konsistonte në mos adresimin e statusit të Kosovës, bëri që BE të aplikonte një

qasje të ashtuquajtur 'neutrale ndaj statusit', e cila më vonë çoi në aplikimin e qasjes tjetër specifike, 'të paqartësisë kreative'. Fillimisht negociatat u quajtën 'negociatat për normalizim të marrëdhënieve', pa specifikuar asnjë element konkret të epilogut të tyre dhe mbi atë se çka në të vërtetë aludohej me termin 'normalizim'. Edhe emërtimet e marrëveshjeve të arritura ishin shpeshherë me dy kuptime (p.sh: Asociacion/Komunitet).

Edhe në rastin e shprehjes së qëndrimeve të tij karshi perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, BE lansoi për herë të parë një qëndrim disi më të qartë për epilogun e dialogut në mes dyja vendeve, i cili duhet të përfundojë përmes një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të obligueshme. Realisht, përdorimi i termit 'gjithëpërfshirëse' i kësaj marrëveshje, prodhoi sërish mundësi për interpretime ambiguitive. Pavarësisht që 'gjithëpërfshirja' përcakton kualitet përmbajtësor në terma juridik, ajo nga disa akterë u interpretua në frymë disi politike. Kështu, udhëheqësit shtetëror të të dyja vendeve, shumë shpejtë, pas interpretimeve që ia bënë këtij termi gjatë gjysmës së parë të vitit 2018, në evenimentin e quajtur 'new perspectives on EU enlargement', i mbajtur në Austri më 25 gusht 2018, dolën me një ide kontroverze për 'korrigjimin e kufijve' në mes të dy vendeve, që do të ishte edhe çelësi i arritjes për një zgjidhje historike paqësore në mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>43</sup>

Edhe pse nuk dihet saktë se çka do të përmbante një marrëveshje e tillë gjithëpërfshirëse, megjithatë dihet se cila do të jetë natyra juridike e saj. Kështu që karakteri i saj si një dokument ligjërish të obligueshëm, apriori, e kualifikon atë drejt termave të një marrëveshjeje të paqes, që madje edhe mund të quhej 'traktat i paqes'. Tanimë një përkufizim i dhënë nga Yawanarajah dhe Ouellet duket se definojnë mjaft qartë nocionin e marrëveshjeve gjithëpërfshirëse:

"Marrëveshjet gjithëpërfshirëse adresojnë përmbajtjen e çështjeve themelore të një mosmarrëveshjeje. Arritja e tyre shpesh shënohet nga një shtrëngim duarsh, duke nënkuptuar një 'moment historik' që i jep fund një konflikti të gjatë. Marrëveshjet

42 Euractiv (2019): Kosovo to keep tariffs until Serbia grants recognition, insists PM (January 24, 2019), i qasshëm në: <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/kosovo-to-keep-tariffs-until-serbia-grants-recognition-insists-pm/>

43 Balkan Insight: "Serbia, Kosovo's Presidents vow for new historic deal, August 26, 2018", i qasshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/08/26/serbian-kosovo-presidents-vows-for-new-history-08-25-2018/>



gjithëpërfshirëse kërkojnë të gjejnë bazën e përbashkët midis interesave dhe nevojave të palëve në konflikt dhe të zgjidhin çështjet thelbësore në mosmarrëveshje”.<sup>44</sup>

Praktika e së drejtës ndërkombëtare njih disa raste të arritjes së marrëveshjeve të paqes me emërtimet “gjithëpërfshirëse”. Ndoshta rastet më përfaqësuese janë: “Korniza për një zgjidhje politike gjithëpërfshirëse të konfliktit në Kamboxhia”<sup>45</sup>; “Marrëveshja Paqësore Gjithëpërfshirëse ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sudanit Jugorë dhe Lëvizjes Çlirimtare të Popullit të Sudanit / Ushtria Çlirimtare të Popullit të Sudanit, e vitit 2002”;<sup>46</sup> “Marrëveshja Gjithëpërfshirëse e Paqes midis Qeverisë së Nepalit dhe Partisë Komuniste të Nepalit (Maoist), e vitit 2006”.<sup>47</sup>

### Parimet dhe elementet përbërëse kyçe të marrëveshjes eventuale Kosovë-Serbi

Në teorinë dhe praktikën e së drejtës ndërkombëtare nuk ka të precizuar një kriter të vetëm, sipas të cilit do të listoheshin elementet përbërëse mbi të cilat do të formulohej një tekst për një marrëveshje paqësore. Tekstet e çdo marrëveshje kanë natyrë unike dhe rregullojnë materie që e imponojnë rrethanat kontekstuale konfliktuale. Së këndejmi, përpjekjet për ta kornizuar tentativisht një draft-marrëveshje të mundshme të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke u bazuar në ndonjë model të ndonjë marrëveshje tjetër, do ta bënin marrëveshjen ‘mekanike’ dhe jo-efektive. Një marrëveshje paqësore Kosovë-Serbi,

do të duhej të ishte origjinale dhe të ofroj zgjidhje për të gjitha mosmarrëveshjet e prodhuara nga konteksti konfliktual ndërmjet dyja vendeve.

Që prej vitit 2013, kur edhe u arrit Marrëveshja e Brukselit, e deri tani, zërat për modalitetin përmbyllës të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve kanë ardhur duke u intensifikuar. Gjatë kësaj kohe janë ofruar shumë ide, plane, e madje janë rekomanduar edhe aso lloj praktikash të zgjidhjes së të gjitha mosmarrëveshjeve duke iu referuar praktikave konkrete, si brenda dhe jashtë Evropës. Dy modelet më të përmendura janë rasti marrëveshjes së vitit 1972 ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës Demokratike Gjermane<sup>48</sup> dhe ai marrëveshjeve të viteve 1972 përkatësisht 1998 ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës.<sup>49</sup>

Nëse i referohemi në përpikëri përmbajtjes konceptuale të qëndrimit të BE-së për një “marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme”, atëherë spektri i çështjeve që do të duheshin rregulluar në kuadër të një marrëveshjeje të mundshme të paqes do të ishte mjaft i gjerë. Natyra e çështjeve për të cilat ka mosmarrëveshje ndërmjet dy vendeve është shumë divezive. Ato derivojnë prej çështjeve që kanë të bëjë me kontestim të subjektivitetit shtetëror dhe integritetit territorial, tek ato që kanë të bëjë me konteste për çështje suksesioni dhe të reparacioneve. Po ashtu, ato derivojnë nga çështje të karakterit teknik e deri te ato me motivacion psikologjik. Thënë konkretisht, një marrëveshje e mundshme paqësore, do të duhej të ofronte zgjidhje për çdo lloj çështje apo kontesti (duke përfshirë edhe çështjet e pazgjidhura gjatë dialogut paraprak), cili mund të vlerësohet se po nuk u trajtua, mund të bëhet potencialisht element kërcënues i cenimit të qëndrueshmërisë së vet asaj marrëveshje, dhe si pasojë, edhe i paqes në përgjithësi.

44 Nita Yawanarajah and Julian Ouellet, “Peace Agreements”, i qasshëm në: <https://www.beyondintractability.org/essay/structuring-peace-agree>

45 Framework for a Comprehensive Political Settlement of the Cambodia Conflict, e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/KH\\_911023\\_FrameworkComprehensivePoliticalSettlementCambodia.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/KH_911023_FrameworkComprehensivePoliticalSettlementCambodia.pdf)

46 The Comprehensive Peace Agreement, e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SD\\_060000\\_The%20Comprehensive%20Peace%20Agreement.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SD_060000_The%20Comprehensive%20Peace%20Agreement.pdf)

47 Comprehensive Peace Agreement between the Government of Nepal and the Communist Party of Nepal (Maoist), e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/NP\\_061122\\_Comprehensive%20Peace%20Agreement%20between%20the%20Government%20and%20the%20CPN%20%28Maoist%29.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/NP_061122_Comprehensive%20Peace%20Agreement%20between%20the%20Government%20and%20the%20CPN%20%28Maoist%29.pdf)

48 Treaty on the Basis of Relations Between the Federal Republic of Germany and the German Democratic Republic and Supplementary Documents, 21 December 1972.

49 Marrëveshja mes Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, dhe Qeverisë së Irlandës, e njohur ndryshe si Marrëveshja e Belfastit apo Marrëveshja e së Premtes së Mirë.

Një dimension tejet kompleks në përcaktimin e një liste me të gjitha çështjet e hapura për të cilët një marrëveshje e paqes do të ofronte zgjidhje, konsiston në atë se ka dallueshmëri të madhe ndërmjet të dyja palëve rreth qëndrimeve parimore se çka në të vërtetë mund të konsiderohet “çështje e hapur” për trajtim. Sigurisht, në fazat e më vonshme të dialogut formal, kompromisi i parë në mes të dyja vendeve do të jetë çështja e saktësisht të të gjitha problemeve që pritet t’i adresoj marrëveshja e paqes.

Në vijim janë dhënë disa nga parimet dhe elementet kryesore që një marrëveshje e paqes eventuale do të duhej t’i përmbante:

- Teksti i marrëveshjes do të duhej të formulohej me dispozita shumë të qarta për nga ana terminologjike. Kjo do të shmangte mundësinë për interpretime ambiguitive të përmbajtjes së marrëveshjes.
- Marrëveshja të jetë e ndërtuar mbi aso parime që janë në frymën e nxitjes së pajtimit në mes dyja vendeve dhe promovimit të një bashkëpunimi ndër fqinjësor, konstruktiv, konform misionit dhe objektivave që Organizata e Kombeve të Bashkuara ka paraparë në kartën e saj.
- Si një marrëveshje e paqes, ajo do të duhej të përçonte edhe mesazh psikologjik të pajtimit dhe krijimit të mirëbesimit në mes të dy vendeve, mbi të cilën fryme, ato do të reflektonin konstruktivitet në perspektivën e bashkëpunimit të ardhshëm në kuadër të mekanizmave rajonal dhe ndërkombëtar.
- Marrëveshja do të duhej të kishte dispozita që rikonfirmojnë gatishmërinë e dy vendeve për t’i konkretizuar të gjitha përgjegjësitë që dalin nga marrëveshjet e arritura gjatë procesit të deritanishëm të dialogut në Bruksel, duke përfshirë dialogun teknik dhe atë politik.
- Saktësimi i afateve kohore për implementimin e dispozitave të caktuara të marrëveshjes duhet të jetë po ashtu njëri nga elementet bazike të kësaj marrëveshje. Një gjë e tillë, do ta evitonte çfarëdo mundësie për manipulim të implementimit të marrëveshjes në terma kohorë për të dyja vendet.
- Lidhur me mundësinë eventuale të themelimit të një “entiteti legal” të komunave me shumicë serbe në Kosovë, marrëveshja do të duhej të garantonte që ky entitet (pavarësisht emrit), nuk do të përbënte një nivel të tretë të qeverisjes dhe që nuk do ta cenonte karakterin unitar të rregullimit shtetëror të Kosovës.
- Në çfarëdo versioni, marrëveshja do të sillte njohje për Republikën e Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë, ku për Kosovën do të garantohej edhe ulëse në OKB.
- Marrëveshja do të duhej ta përshkruante me terma të qartë pacenueshmërinë e integritetit të tanishëm territorial të të dyja vendeve gjatë procesit të demarkimit të kufirit me Serbinë, dhe se ai kufi do ta kishte statusin e kufirit në mes dy shteteve sovraane.
- Lidhur me modalitetet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes dy vendeve (e që do të derivonte nga njohja reciproke), marrëveshja do të duhej të përmbante dispozita specifike që do t’i referoheshin konventave ndërkombëtare të specializuara për rregullimin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore ndërmjet shteteve.
- Në sfondin e saj, marrëveshja duhet të vendosë terma të qartë për bashkëpunimin ndërmjet dyja vendeve për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Dispozitat duhet të jenë të natyrës obliguese në përputhje me standardet ndërkombëtare për çështjet e personave të pagjetur.
- Marrëveshja duhet të ketë dispozita specifike që rregullojnë çështjen e të drejtave dhe obligimeve si një shtet suksesor. Çështja e suksesionit do të duhej të fokusohet në lidhje me traktatet dhe borxhet.
- Lidhur me trashëgiminë religjioze dhe kulturore, Kosova do të duhej ta rikonfirmonte gatishmërinë shtetërore për mbrojtjen e kësaj trashëgimie, pavarësisht linjave etnike të identifikimit të saj. Kjo do të duhej të bëhej në frymën e rindërtimit të besimit reciprok dhe pranimi të diversitetit religjioz e fetar si një vlerë pozitive e shoqërisë kosovare. Në këtë drejtim, nuk do të duhej të kalohej përtej kompro-

misit të përfshirë në 'Pakon e Ahtisaarit', përveç nëse është nevoja për nxjerrjen e akteve juridike shtesë nga institucionet e Kosovës që do të mundësonin realizimin sa më efektiv të kësaj objektive.

- Marrëveshja do të mund të përmbante edhe dispozita që do të rregullonin materie të caktuar për të cilën dyja vendet do të dakordoheshin në fazën formale të negociatave të draftimit të marrëveshjes, por që do të ishin në përputhje me frymën e garantimit të paqes dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

### Modaliteti dhe mekanizmat e garantimit dhe të implementimit të marrëveshjes

Gjendja e mos implementimit të të gjitha marrëveshjeve (sidomos nga ana e Serbisë), të arritura gjerë më tani në dialogun e Brukselit, e ka diskredituar ndjeshëm seriozitetin e palës serbe dhe ka vënë në pikëpyetje kredibilitetin e BE-së si palë lehtësuese. Dyshimet në sytë e lidhshpimit dhe qytetarëve të Kosovës janë rritur edhe më shumë lidhur me qëndrimet kontaverse të BE-së lidhur me idetë e fundit për korrigjim të kufirit Kosovë-Serbi, si mundësi për një zgjidhje gjithëpërfshirëse. edhe në formë të prononcimeve zyrtare, edhe ish-kryeministri dhe presidenti i Kosovës, kërkojnë një përfshirje direkte të ShBA-ve në këtë proces.<sup>50</sup> Një përfshirje e ShBA-së, nga ana e palës kosovare vlerësohet tejet me rëndësi dhe jetike për mbarëvajtjen e finalizimit të dialogut, dhe më pas, edhe të implementimit të marrëveshjes eventuale paqësore. Adut të fortë për një vlerësim të tillë për Kosovën është edhe mos kompaktësia e BE-së ndaj njohjes së shtetësisë së Kosovës për shkak të pesë anëtarëve të saj që vazhdojnë të mbesin të barrikaduara në pozicionet e tyre fillestare duke mos e njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Realisht, praktika e garantimit të marrëveshjeve të paqes nga ana e palëve të treta, ka dëshmuar se prania e ShBA-ve si garantuese ka qenë determinuese për

jetëgjatësinë e këtyre marrëveshjeve. Në kontekst të tanishëm, përfshirja e ShBA-ve në këtë proces, vazhdon të mbetet në nivel debatesh. Përveç asaj që është e ditur tanimë se do të ketë një angazhim serioz të tyre në këtë fazë të dialogut, mbetet të qartësohet se në çfarë cilësie do të jetë ky angazhim. Nuk është e qartë nëse ShBA-të do të angazhohen vetëm si mbështetëse e BE-së në lehtësimin e pjesës së mbetur të dialogut, dhe me një rol inkurajues për të dyja vendet që të lëvizin përpara drejt një marrëveshje finale, apo do të ta merrte një rol të ndërmjetësuesit dhe eventualisht të garantuesit të marrëveshjes.

Lidhur me mekanizmat që do të luanin rolin e monitoruesit dhe garantuesit, marrëveshja do të duhej të ofronte mundësi për një përfshirje sa më të gjerë të mekanizmave ndërkombëtar, në radhë të parë ShBA-të, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe Francën, si dhe organizata si BE, OSBE-në, etj. Në raport me rolin që do ta kishte BE si palë garantuese, do të duhej që të aplikoheshin edhe më tej masat kushtëzuese për Serbinë për të përmbyllur 'Kapitullin 35' të *aqui-s*, dhe në faza të mëvonshme, kushtëzimet të lidheshin me fazën e ratifikimit të traktatit për anëtarësimin e saj në BE. Normalisht, edhe për Kosovën, BE do të duhej ta përdorte instrumentin e kushtëzimit për hapjen e negociatave për statusin e vendit kandidat. Krejt këto masa do të mund të aplikoheshin, në rast se ka vlerësime reale për mos implementim të marrëveshjes eventuale. E këtë gjendje do ta konstatonte një trupë e përbashkët punuese, e cila do të ishte në përbërje të përfaqësuesve të Kosovës, Serbisë, ShBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Francës dhe BE-së. Natyrisht, meqenëse praktika e së drejtës ndërkombëtare lejon, që me vullnetin e palëve, brenda një marrëveshje të parashihen dispozita edhe për mekanizmat ndërkombëtar të cilëve ato mund t'i drejtohen për t'i zgjidhur në mënyrë paqësore mosmarrëveshjet eventuale në mes tyre. Edhe në rastin e marrëveshjes eventuale Kosovë-Serbi, do duhej që palët t'i referoheshin Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969 (nenit 66)<sup>51</sup>, si instrument që i udhëzon palët për mënyrat se si ato do t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet në fazën e implementimit të një marrëveshje.

50 Beta (2017): Haradinaj kërkon që Shtetet e Bashkuara të përfshihen në negociatat për Kosovën ( 09 qershor, 2019, e qasshme në: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav\\_id=101508](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav_id=101508); Klan Kosova (2017): Thaçi ka kërkuar përfshirjen e SHBA-së në dialog me Serbinë Klan Kosova, (02 shtator, 2017), e qasshme në: <https://klankosova.tv/thaci-ka-kerkuar-perfshirjen-e-shba-se-ne-dialog-me-serbine/>

51 Vienna Convention on the Law of Treaties, May 23, 1969, Art.66.

## Konkluzione dhe rekomandime

Edhe pse kohëve të fundit vërehet një lloj shtytje nga bashkësia ndërkombëtare ndaj të dyja vendeve që të rikthehen në dialog për ta finalizuar atë përmes një marrëveshje finale, megjithatë imponimi i agjendave të caktuara për negociim që do të ishte kundër vullnetit të Kosovës, do të ishte kundër vetë logjikës së procesit paqësor dhe do ta diskreditonte fuqishëm të gjithë procesin.

Nga shqyrtimet e mësipërme vërehet se ekzistojnë skenarë dhe modalitete për përfundim të dialogut, duke mos lënë anash as një lloj marrëveshje që do të kishte implikime për ndryshime territoriale. Madje, kohëve të fundit, skenarë të tillë kanë marrë miratim heshtas apo hapur nga shumë akterë ndërkombëtar. Për palën kosovare, një zgjidhje e tillë duhet përfshiruar në çdo variant. Sigurisht, siç bëhet e ditur nga disa burime<sup>52</sup> një përfshirje direkte e SHBA-ve në këtë proces, do të hapte dyert për një kërkesë të Rusisë që ta bënte të njëjtën gjë.<sup>53</sup> Faktikisht, pala serbe do ta mirëpriste një përfshirje të tillë ruse, dhe kjo gjë tanimë konsiderohet opsion real në qarqet politike në Serbi. Ky skenarë, do ta fuqizonte jashtëzakonisht shumë pozicionin e Serbisë lidhur me shtyrjen përpara të agjendës së saj për ndarje të Kosovës, si kompromisi më real për Serbinë.<sup>54</sup>

Do të ishte shumë me rëndësi që përgjatë fazës finale të konkludimit të një marrëveshje, të dyja vendet t'i implementonin disa nga marrëveshje që rregullojnë probleme që prekin përditshmërinë e qytetarve të Kosovës, siç janë: marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave universitare, marrëveshja për energjinë, si dhe marrëveshja për përfaqësim dhe

bashkëpunim rajonal. Kjo do të ofronte më shumë mundësi që krijohet një klimë më relaksuese në termat e pranueshmërisë më të lehtë të marrëveshjes finale nga masat e gjera qytetare nga të dyja vendet. Të dyja vendet duhet të rikthehen në dialog dhe Kosova duhet të tregojë përkushtim për arritjen e një marrëveshje që nuk e cenon integritetin territorial dhe rendin kushtetues të saj. Si kompensim për këtë, pala kosovare duhet të vazhdojë ofroj një trajtim korrekt të serbëve të Kosovës (dhe komuniteteve tjera jo-shumicë), konformë zotimeve të dhëna me anë të deklaratës së shpaljjes së pavarësisë, dispozitave kushtetuese dhe rendit ligjor në fuqi. Një trajtim i tillë, do ta fuqizonte pozitën e Kosovës përballë kërkesave të palës serbe për kompromise tjera. Në rrafshin ndërkombëtar, kjo do ta forconte imazhin e Kosovës si shtet që promovon njëri nga vlerat më të rëndësishme të vet BE-së, pra bashkëjetesën ndëretnike të standardeve më të larta. Garantimi i të drejtave të serbëve nga ana e institucioneve të Kosovës, do ta mbante Serbinë në detyrim përballë bashkësisë ndërkombëtare për ta pranuar shtetësinë e saj, dhe do ta çrrënjoste alibinë serbe për të ndërrhyrë në punët e brendshme të Kosovës në emër të përkujdesjes për qytetarët serb që jetojnë në Kosovë.

Ndërtimi i një konsensusi të brendshëm politik, me një përfshirje sa më të gjerë të të gjithë akterëve politik vendor në Kosovës, do ta fuqizonte pozitën negociuese të Kosovës përballë kërkesave destruktive të Serbisë, dhe njëkohësisht, do bëhej i mundur amortizimi më efikas i presioneve ndaj Kosovës që mund të vijnë nga bashkësia ndërkombëtare. Po ashtu, pavarësisht presioneve të jashtme, dinamika kohore e dialogut nuk duhet të bëhet në asnjë moment çështje më e rëndësishme se sa përmbajtja e tij dhe rezultati final.

52 RIDEA & BPRG, Prill, 2018, f. 23.

53 B92 (2019): It is in Russia's interest that Kosovo issue remains unresolved? (18 November 2019), e qasshme në: [https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2019&m=11&dd=18&nav\\_id=107526](https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2019&m=11&dd=18&nav_id=107526); IndeksOnline (2018): Analistët serbë: Duhet përfshirja e SHBA-ve dhe Rusisë në dialogun me Kosovën (22 Nëntor 2018), e qasshme në: <https://indeksonline.net/analistet-serbe-duhet-perfshirja-e-shba-ve-dhe-rusise-ne-dialogun-me-kosoven/>

54 Po aty, f.23.

## Literatura

- A** Arist von Hehn (2011): *The internal Implementation of Peace Agreement after Violent Intra-state Conflict*, Martinus Nijhoff Publishers, Lieden, Boston, 2011.

Antonio Cassese (2005): *International Territorial Law* 63.

- B** Balkan Insight: "Serbia, Kosovo's Presidents vow for new historic deal, August 26, 2018", e qasshme në: <https://balkaninsight.com/2018/08/26/serbian-kosovo-presidents-vows-for-new-history-08-25-2018/>

Beta (2017): Haradinaj kërkon që Shtetet e Bashkuara të përfshihen në negociatat për Kosovën (09 qershor, 2019), e qasshme në: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav\\_id=101508](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav_id=101508)

B92 (2019): It is in Russia's interest that Kosovo issue remains unresolved? (18 November 2019), e qasshme në: [https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2019&mm=11&dd=18&nav\\_id=107526](https://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2019&mm=11&dd=18&nav_id=107526)

KlanKosova (2017): Thaçi ka kërkuar përfshirjen e SHBA-së në dialog me Serbinë' KlanKosova, (02 shtator, 2017), e qashme në: <https://klankosova.tv/thaci-ka-kerkuar-perfshirjen-e-shba-se-ne-dialog-me-serbine/>

- C** Center for social dialogue and regional initiatives (CSDRI), 'Normalization of relations between Belgrade and Pristina from citizens perspective - What we know and what we feel?', Belgrade, October 2019.

Comprehensive Peace Agreement between the Government of Nepal and the Communist Party of Nepal (Maoist), e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/NP\\_061122\\_Comprehensive%20Peace%20Agreement%20between%20the%20Government%20and%20the%20CPN%20%28Maoist%29.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/NP_061122_Comprehensive%20Peace%20Agreement%20between%20the%20Government%20and%20the%20CPN%20%28Maoist%29.pdf)

Conference on Security and Co-Operation in Europe Final Act, HELSINKI (1975), i qasshëm në: <https://www.osce.org/helsinki-final-act?download=true>

Christine Bell: Peace Agreements: Their Nature and Legal Status, *The American Journal of International Law* · May 2008.

- E** Euractiv (2019): Kosovo to keep tariffs until Serbia grants recognition, insists PM (January 24, 2019), i qasshëm në: <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/kosovo-to-keep-tariffs-until-serbia-grants-recognition-insists-pm/>

European Commission (2018), 17, i qasshëm në: [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)

- F** Fen Osler Hampson (1996): *Nurturing peace: why peace settlements succeed or fail*, United States Institute of Peace Press.

Final Agreement for the Settlement of the Differences as Described in the United Nations Security Council Resolutions 817 (1993) And 845 (1993), The Termination of the

Interim Accord of 1995, and the Establishment of a Strategic Partnership Between the Parties, (2018), e qasshme në: <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/spogodba-en.pdf>

Framework for a Comprehensive Political Settlement of the Cambodia Conflict, e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/KH\\_911023\\_FrameworkComprehensivePoliticalSettlementCambodia.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/KH_911023_FrameworkComprehensivePoliticalSettlementCambodia.pdf)

- G** Gazeta Metro: "Francezët e zënë ngushtë Vucicin: Nëse jo shkëmbimi, çfarë është për ty kompromisi?", (23/11/2019 | 15:32), e qasshme në: <http://gazetametro.net/francezet-e-zene-ngushte-vucicin-nese-jo-shkembimi-ctfare-eshte-per-ty-kompromisi/>

Ghassem Bohloulzadeh, "The Nature of Peace Agreement in International Law", *Journal of Politics and Law*; Vol. 10, No. 2; 2017, p.208; Christine Bell: Peace Agreements: Their Nature and Legal Status, *The American Journal of International Law* · May 2008.

General Assembly, Resolution adopted by the General Assembly on 20 December 2018 (A/RES/73/210), 14 January 2019, e qasshme në: <https://treaties.un.org/doc/source/docs/A-RES-73-210-Eng.pdf>

*Government of Kosovo* 2016: 6, e qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REPORT\\_-Brussels\\_Agreements\\_Pending\\_Implementation\\_060717.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REPORT_-Brussels_Agreements_Pending_Implementation_060717.pdf)

- I** IndeksOnline (2018): Analistët serbë: Duhet përfshirja e SHBA-ve dhe Rusisë në dialogun me Kosovën (22 Nëntor 2018), e qashme në: <https://indeksonline.net/analistet-serbe-duhet-perfshirja-e-shba-ve-dhe-rusise-ne-dialogun-me-kosoven/>

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) & Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG), Skenarët e 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Prill, 2018.

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA), "Zëri i Popullit rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë" (Vëllimi II), Qershor 2016.

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA), "Studim mbi substancën dhe gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut Kosovë-Serbi", Tetor 2019.

International Court of Justice (2010): Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo. Request for Advisory Opinion (22 July 2010), icj Reports, 403.

- K** Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

- M** Malcolm Shaw (2003): *International Law – Fifth Edition*, Cambridge University Press, 2003.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) & Transparency International Kosova: Dialogu Kosovë – Serbi: sfidat dhe rruga përpara, Mars 2018.

Miruna Troncota: "Brussels Based Talks are a Dialogue of the Deaf", Kosovo 2.0 (23.02.2017), at <https://kosovotwopointzero.com/en/brussels-based-talks-dialogue-deaf/>



- N** Nita Yawananarajah and Julian Ouellet, "Peace Agreements", i qasshëm në: [https://www.beyondintractability.org/essay/structuring\\_peace\\_agree](https://www.beyondintractability.org/essay/structuring_peace_agree)
- P** Paul R. Hensel (2001): *The More Things Change: Recognizing and Responding to Trends in Armed Conflict*: Florida State University, 2001.
- Peace Agreements 1975-2011 - Updating the UCDP Peace Agreement Dataset STINA HÖGBLADH Uppsala Conflict Data Program (UCDP), Department of Peace and Conflict Research, Uppsala University, p. 44, i qasshëm në: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.739.1886&rep=rep1&type=pdf>
- Peter Wallensteen & Margareta Sollenberg, "Armed Conflicts, Conflict Termination and Peace Agreements, 1989-96", *Journal of Peace Research*, vol. 34, no.3, 1997.
- President of Kosovo 2018*, i qasshëm në: <https://www.president-ksgov.net/en/news/president-thaci-received-a-letter-from-the-president-of-the-usa-donald-trump>
- President of Kosovo 2019*, i qasshëm në: <https://www.president-ksgov.net/en/news/president-trump-congratulates-president-thaci-on-the-11th-anniversary-of-the-independence-reiterates-the-importance-of-normalisation-of-relations-with-serbia>
- T** Treaty on the Basis of Relations Between the Federal Republic of Germany and the German Democratic Republic and Supplementary Documents, 21 December 1972.
- The Comprehensive Peace Agreement, e qasshme në: [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SD\\_060000\\_The%20Comprehensive%20Peace%20Agreement.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SD_060000_The%20Comprehensive%20Peace%20Agreement.pdf)
- The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina (1995), i qasshëm në: <https://www.osce.org/bih/126173?download=true>
- U** U.S. Embassy in Serbia: Join Statement by the Governments of France, Germany, Italy, the United Kingdom and the United States, e qasshme në: [https://xk.usembassy.gov/joint\\_statement\\_by\\_ambassadors/](https://xk.usembassy.gov/joint_statement_by_ambassadors/)
- UN General Assembly Resolution (2010): Request for an Advisory Opinion of the International Court of Justice on Whether the Unilateral Declaration of Independence of Kosovo Is in Accordance With International Law (13 October 2010) A/RES/64/298, e qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezoluta\\_e\\_OKB\\_per\\_Dialogun\\_e\\_Brukselit\\_e\\_9\\_Shtator\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezoluta_e_OKB_per_Dialogun_e_Brukselit_e_9_Shtator_2010.pdf)
- United Nations, 'Treaty Collection', e qasshme në [https://treaties.un.org/Pages/Content.aspx?path=DB/UNTS/pageIntro\\_en.xml](https://treaties.un.org/Pages/Content.aspx?path=DB/UNTS/pageIntro_en.xml)
- V** Vienna Convention on the Law of Treaties, May 23, 1969, Art. 2, 1155 UNTS 331. E qasshme në: [https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1\\_1\\_1969.pdf](https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf)
- Z** Zejnullah Gruda (2003): *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Universiteti i Prishtinës, 2003, f.277.

